

Vizionimi i qytetit tuaj

Vizionimi është aktivitet që përafroon qytetarët dhe pjesëmarrësit për të formësuar një vizion të përbashkët për të ardhmen e bashkësisë së tyre (komunës, qytetit, qytezës apo fshatit). Qëllimi i vizionimit është të nxirren deklarata të shkruara dhe vizuale të qëllimeve afatgjate dhe synimeve strategjike të bashkësisë në planifikimin urban dhe hapësinor.

Me këtë broshurë dëshirojmë të promovojmë konceptin e Vizionimit si element thelbësor në proceset e planifikimit përfshirës hapësinor lokal, që zbatohet në gjitha komunat e Kosovës.

Cilat janë karakteristikat e një vizioni të fuqishëm?

- Shikon synimet afatmesme dhe afatgjata (5-20 vjet) dhe motivon veprimet e menjëhershme
- Është i qëndrueshëm në aspektin mjedisor, social dhe ekonomik, dhe është i integruar në aspektin hapësinor
- Është rezultat i diskutimit mes gjitha palëve të përfshira, pra komunitetit dhe pjesëmarrësve
- Është vizionar, por real
- Është i lehtë të shpjegohet dhe kuptohet edhe nga jo-profesionistët
- Është i thurur brenda procesit të vendim-marrjes publike në planifikim
- Është i mbështetur me një përkushtim të fuqishëm në implementimin e atij Vizioni.

Pse Vizionimi?

- Për të inspiruar, përqendruar vëmendjen dhe mobilizuar gjithë banorët, pjesëmarrësit, politikanët dhe zyrtarët në krijimin e së ardhmes së dëshiruar për zonën (komunale).
- Për të mobilizuar investitorët për të investuar në zhvillimet e dëshiruara për të ardhmen

- Për të zbatuar Ligjin mbi Planifikimin Hapësinor, si element thelbësor i Planit Zhvillimor Komunal në komunën tuaj
- Për të ndërtuar pajtimin dhe ndjenjën e pronësisë lokale mbi Planin Zhvillimor Urban dhe atë Komunal.

Aktorët në Vizionim

- Pjesëmarrësit e zonës
- Shoqëria civile, sidomos rinia, fëmijët dhe pakicat
- Planerët hapësinorë (dizajnerë dhe jo-dizajnerë)
- Moderatorë/ndërmjetës
- Vendim-marrësit



Njerëzit e moshave, gjinive, historive dhe kulturave të ndryshme shpesh kanë perspektiva të ndryshme. Duke siguruar që spektri i plotë i një komuniteti është përfshirë në ushtrimin e Vizionit, ofrojmë një vizion të fuqishëm dhe përfshirës. Aktorët/ pjesëmarrësit nuk duhet të frikësohen nga "konsulentët" dhe "profesionistët" me përvojë, por të sigurojnë që procesi i planifikimit të Vizionit dhe Komunitetit është "pronë" e banorëve të vendit dhe palëve me interes.

Vizionimi në hapa

1. Përzgjedhja e temave hapësinore

- Uji, natyra dhe mjedisi
- Infrastruktura dhe lëvizshmëria (mobiliteti)
- Mjedis i ndërtuar
- Mjedis rural
- Mjedis kulturor

2. Krijimi i pasqyrës hapësinore

- Me analizë SVOT (shikim i shpejtë)
- Duke vizatuar dhe përshkruar strukturën ekzistuese hapësinore
- Duke identifikuar çështjet kryesore dhe motorët e ndryshimit.

	Përparsitë	Dobësitë
Mundësitë	Ofanzive Vazhdo kështu	Transformuese Ndryshoje
Kërcënimet	Defanzive Mbaje	Mbijetesa Lufto për të

3. Hartimi i Deklaratës(ave) të Vizionit në fjalë e imazhe

Deklarata e Vizionit

- Duhet të jetë e shkurtër dhe të shprehet kryesisht me fjalë
- duhet të ofrojë një apo më shumë perspektiva në lidhje me zhvillimin e synuar të një zone.
- Historia e zonës, cilësitë, asetet e mundësitë e zonës janë themelet e një vizioni të fuqishëm.
- Duhet të shprehë një ndjenjë të identitetit lokal/rajonal.

Konceptet hapësinore

- Përdoren për të vizualizuar deklaratën(at) e Vizionit
- Mund të jenë konceptuale, por duhet të jenë specifike, të arritshme dhe komunikative
- Mund të shprehen me anë të metaforës.

Koncepti hapsinor i "Zemrës së Gjelbërt të Randstandit" (Holandë)



Koncepti famshëm i "Randstadit dhe Zemrës së Gjelbërt" ka të bëjë me krijimin e një brezi urban me formë patkoi, me 4 qytetet më të mëdha të Holandës, derisa mbrohet pjesa e brendshme si Zemër e Gjelbër, ndërsa pjesa së jashtmi si kryesisht rurale. Ky koncept ka dominuar gjithë politikën hapësinore holandeze qysh prej Luftës së II Botërore.

4. Planifikimi i veprimeve dhe monitorimi i përparimit


- Planeri i Veprimit mund të përdoret në punëtorinë e vizionit për të treguar çfarë veprimi është i nevojshëm, nga kush, kur dhe cili është prioriteti i tij
- Monitori i Përparimit përmbledh rezultatet e aktivitetit të planifikimit në bashkësi dhe planifikon veprimet që duhen ndërmarrë në të ardhmen.

Metodat për të nxjerrë Vizionin për Komunitetin

Ekzistojnë disa metoda e teknika që mund të përdoren për ndërtimin e Vizionit për një qytet, si:

- Seancat njoftuese
- Seancat e diskutimeve plenare
- Grupet punuese
- Seancat e dizajnit
- Seancat e shqyrtimit
- Prezentimet në medime të ndryshme.

Koha e nevojshme për një punëtori të suksesshme vizionimi mund të jetë nga një gjysmë dite deri në një javë të plotë. Java ose fundjava e vizionimit është mënyrë elaboruese, por tejet efektive e ndërtimit të dinamikës së ndryshimit, si dhe përfshirjes së gjitha palëve në prodhimin e një vizioni të shëndoshë, si dhe një plani veprimi për një lokacion, lagje apo qytet. Seancat kryesore të punëtorisë, e sidomos paraqitja e rezultateve përfundimtare, duhet të jenë të hapura për publik.



Si mund të kontribuoj në Vizionimin e qytetit tim?

- Duke inicuar, organizuar apo marrë pjesë në punëtori vizionimi
- Duke identifikuar potencialet e qytetit tim
- Duke dhënë idetë e mia kreative për definimin dhe vizualizimin e deklaratës(atave) të vizionit të qytetit.



Çka pas Vizionit?

- Pas hartimit të vizionit, ka nevojë për një debat publik dhe komunikim të suksesshëm për të marrë përkushtimin e gjerë të gjithë bashkësisë. Kështu, vizioni duhet publikuar gjerësisht dhe duhet mbajtur gjallë, për shembull duke i raportuar publikut arritjet e monitoruara rregullisht.
- Vizioni për qytetin mund të zbërthehet në një Vizion më detaj për një lagje apo lokacion të caktuar.
- Një vizion për qytet nuk është statik, por duhet shqyrtuar ose edhe zëvendësuar me një vizion të ri, kurdo që rrethanat në planifikim të kenë ndryshuar thelbësisht.

Burimet dhe referimet

- Doracaku i Planifikimit Komunitar, Nick Wates, Earthscan Publications, 2002 (www.communityplanning.net)
- Veglat për mbështetjen e Vendim-marrjes Pjesëmarrëse urbane, UN-HABITAT (www.unhabitat.org/govern)
- Punëtoritë Pjesëmarrëse, Robert Chambers, Earthscan, 2004

Punëtorja e Vizionimit Funksionon!



Bashkë Krijojmë Qytete Më të mira

Për të siguruar një jetë më të mirë për gjithë qytetarët, Kosova ka nevojë për qytete më të mira. Kjo mund të arrihet vetëm përmes planifikimit dhe punës së përbashkët. "Bashkë krijojmë qytete më të mira" është motoja e Programit të Mbështetjes së Planifikimit Hapësinor Komunal, financuar nga SIDA, përmes të cilit UN-HABITAT-i do të mbështesë planifikimin komunal hapësinor në Kosovë. Planet duhet të jenë strategjike dhe të orientuara në veprime, detaje në planet rregullative urbane dhe të zbatuara me investime private e publike. Gjashtë qytetet sekondare të Kosovës – Peja, Gjakova, Prizreni, Mitrovica, Ferizaj dhe Gjilani – mund të kontribuojnë në një zhvillim më të drejtpeshuar të Kosovës dhe të zvogëlojnë migrimet e vazhdueshme të popullsisë drejt kryeqytetit, Prishtinës. Përmes integritit në rrjetin urban evropian, qytetet dhe qytetarët e Kosovës do të lidhen me qytete tjera evropiane. Kjo mund të arrihet duke tërhequr investimet në zhvillimin e qëndrueshëm urban dhe duke përmirësuar qasjen për të gjithë. Investimet private janë të nevojshme për t'u kombinuar me ato publike, drejt sigurimit të shërbimeve më të mira për qytetarët: banim të përshtatshëm social, spitale, shkolla, transport publik, rrugë, si dhe përfundimisht, por jo më pak e rëndësishme, hapësirat atraktive publike për t'i kënaqur nevojat e një shoqërie në ndryshim.

Impressum



UN-HABITAT



*Programi i Mbështetjes
së Planifikimit Hapësinor
Komunal (MuSPP)*

Zyrtari Përgjegjës
Krystyna Galezia
galezia@un.org

Zyra:
UN-HABITAT Kosovo
Nazim Gafurri Str, No. 33,
10000 Prishtina, Kosovo

Tel.: +381/38/517835
Fax: +381/38/517836

*<< Bashkë bëjmë
qytete më të mira >>*

Informimi dhe komunikimi/
Marrëdhëniet Publike
Lumnije Gashi
lumnije.gashi@unhabitat-kosovo.org

Më shumë informata mbi
MuSPP / UN-HABITAT:
www.unhabitat-kosovo.org

Kjo Fletushkë është iniciativë e UN-HABITAT-it Kosovë, si vegël komunikimi e Programit të Mbështetjes të Planifikimit Hapësinor Komunal (MuSPP). Teksti është shkruar nga Frank D'hondt, Koordinator i Planifikimit Hapësinor në MuSPP, ndërsa koordinuar nga Lumnije Gashi, Zyrtare Informimi e Komunikimi/MP në MuSPP. Grupi i synuar i Fletushkës është parësisht grupi i palëve me interes në planifikim në komunat e Kosovës, në veçanti gjashtë "Qytetet e MuSPP-it".